



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 14.7.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE MJEDIS E
PLANIFIKIM HAPËSINOR

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Salih Salihu, Murat Hoxha.

Munguan: Shaip Muja, Srdjan Popovich.

Të ftuar dhe pjesmarrës të tjerë: Sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi Fikrim Damka, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.6.2015,
3. Shqyrtimi i realizimit të subvencioneve dhe granteve nga Ministria e bujqësisë, i ftuar ministri,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.6.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i realizimit të subvencioneve dhe granteve nga MB

Fikrim Damka – kryetar i komisionit, përshëndeti dhe falënderoj për pjesmarrje ministrin **Memli Krasniqi** dhe bashkëpunëtorët **Shasivar Haxhija** dhe **Shkelzen Dragaj**, të cilëve ju sqaroi kërkesën e komisionit për këtë temë sidomos për ato subvencione dhe grante që janë menaxhuar në këtë legjislacion nga kjo ministri. Ministri falënderoi për bashkëpunim dhe rikujtoi të dhënat e fundit që i ka dhënë në këtë komision për të ndërlidhur me ato sot që do ti prezantoi. Ai konstatoi se nuk mund të flitet për ndonjë ndryshim rrënjësor në realizimin e pagesave në këtë ministri, mirëpo sa i përket fermerëve ato janë realizuar 100% dhe kanë përfunduar poashtu. Intenca është, vazhdoi, që sa më tepër të ritet transparencja rreth programit të këtij viti ku fermerët kanë aplikuar dyfish më tepër (2126 aplikime) dhe poashtu financimi është dyfishuar (23 milion euro) dhe atë në bazë të 4 masave të parapara që do të ndikojnë në ritjen e suksesit të fermerëve në degë të ndryshe siç janë pemëtaria, trashja e viçave, qumështi, bletaria etj. Momentalisht është duke u zhvilluar faza e kontrollit dhe ankimimit, ndërkaq problemi qenësor tha se është mungesa e kapacitetit njerëzor në agjencinë e zhvillimit të bujqësisë përkundër faktit që është ritur buxheti i subvencioneve dhe granteve, kjo do të reflektoj negativisht sidomos kur rriten mundësitë për ti ndihmuar fermerëve, ngase ky problem nuk mund të zgjidhet me ndonjë transfer afatshkurtër të personelit. Duhet të ritet bashkëpunimi me agjencinë evropiane sidomos kur vijnë ndihmat dhe kur rriten fondet. Sa i përket pagesave direkte ato kanë përfundua sipas prioriteteve dhe parashihet të përfundojë deri në gjysmën e muajit gusht. Ai tha se shuma 23 milion nuk janë pak dhe potencoi numerikisht sa është paraparë veq e veq, për misër, pemishte, gjedhe, fara etj

Lahi Brahimaj duke u nisur nga rajoni i Gjakovës pyeti për aplikimet për të cilat krijohen probleme mu në ditën e fundit të aplikimit duke u njoftuar nga zyrtarët se mungon ky apo ai dokumentacion, kështu që qëllimisht eliminohen fermerët e caktuar. Potencoi edhe disa probleme me shembuj konkret p.sh. dështimi i farës së luledielli, pse nuk paguhet me kohë për farën e grurit, për naftën, mungesën e tregut për shumë produkte-kultura, mbrojtja e produkteve vendore, në radhë të parë qumështit etj.

Adem Salihaj përsëriti kërkesën mundësisht për dërgimin e emrave nga MB rreth granteve për 2014 dhe 2015, ngase kërkesa nuk është bërë precize nga stafi, edhe pse ndoshta janë refuzuar, gjithashtu afatet e aplikimeve duhet të operacionalizohen dhe të caktohen afatet saktë ngase në këtë drejtim nuk ka arsimim të mjaftueshëm tek fermerët tanë, investimet të drejtohen në sektorin e analizave ngase ndihma duhet të ketë efekt, e jo të shpërndahen të hollat por pastaj të mungoi zhvillimi (ka dikush që merr por thjesht investon në blerje të miellit), pra duhet angazhim si duhet të ndodhë zhvillimi, pse ndodhin këto probleme me qumështin vendorë, pse importojmë më tepër grurë sesa që na nevojitet, ku është efekti i investimeve, pse bëjmë punë të kotë, pse nuk ndodhë kuotizimi i prodhimeve-kulturave, nëse kemi kaq para për grurë atëherë të blejmë sa duhet e jo vetëm të blejmë pa ndonjë politikë të saktë, bujqit punojnë pa plan dhe sipas stihisë pa studiuar tregun, si mund të ndodhë një produkt i Serbisë të jetë më konkurrent te na

sesa produkti jonë dhe shumë gjëra tjera. Ai theksoi se këtu jemi të gjithë fajtorë bashkërisht ngase planin duhet bërë bashkë, investimet nuk do të kanë efekt nëse nuk i analizojmë efektet e cekura.

Emilija Redzepi potencoi faktin se pakicat nuk janë për me i marr milionat, por janë të zhgënjyer për injorancën rreth ndarjes së subvencioneve ku nuk përfshihen ata, pakica boshnjake, sidomos për blegtori. Kërkoi barabarësi më të madhe dhe kujdesin maksimal nga MB rreth aplikacioneve ku zyrtarët manipulojnë, njësoj edhe pakica serbe ka këto probleme, vazhdoi ajo, përfaqësuesi i së cilës ka përcjellë këtë mesazh për këtë mbledhje përmes sajë.

Salih Salihu mbështeti diskutimet e kolegëve dhe shtoi se kur ka shumë aplikime mundësitë janë më të mëdha për manipulime, por më e rëndësishme është që fermerit që meriton ti ndihmohet e jo atij që lufton vetëm për të holla, p.sh. për shkak të subvencionit mbjell kungull në kohën kur nuk është koha e kësaj kulture. 20 milion janë para të mira, por nëse nuk ka specifikime kjo është dështim. Si mos të kolapsoi çështja e grurit dhe qumështit nëse nuk kontrollohet kufiri, te ne hyn malli përmes Bosnës kurse ajo nuk pranon mallin tonë, a duhet edhe na me pas masa, na harxhojmë para por nuk zhvillohemi, nuk ka treg për fermerin tonë, ne duhet ta duam shtetin tonë pastaj janë tjerat, nga rezerva e shtetit të Serbisë vjen gruri të cilin prodhuesi ynë e bluan dhe e përzien me grurin vendor dhe e shet për 25 cent që dmth prodhuesi ynë asnjëherë më nuk mbjellë grurë sepse nuk ka llogari, apeloj të hiqet monopoli dhe të normalizohet tregu ynë.

Murat Hoxha fillimisht theksoi mungesën e edukimit të fermerëve gjatë aplikimeve për çka potencoi shembullin e “inkubatorit të trajnimeve” në Lipjan (ministri tha se për këtë nuk ka dëgjuar) dhe caktimin e kriterëve për ndarjen e granteve ngase duhet të kërkohen rrugë dhe mundësi të reja për të ndihmuar fermerëve, të shikohet ndryshimi i konceptit a duhet të subvencionohet prodhimi apo shitja, të analizohet sa kushton një vend i përhershëm i punës që sipas tij nuk është 7000 euro por 15.000 euro etj.

Memli Krasniqi së pari shprehu habinë me faktet që parashtrori z. Brahimaj rreth manipulimeve me aplikacione, ngase pikërisht këto fakte MB po i ndjekë për të parashtruar kallëzimet penale. Lidhur me farërat faza e inspektiveve ka ndodhur dhe MB gjendet në rrugën legale me përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e tregut të lirë, ndërsa për subvencionimin e naftës tha që janë në dijeni për manipulimet që ndodhin, MB mendon se është më mirë me rit vlerën e subvencionit sesa të subvencionohet nafta. Lidhur me vërejtjet e z. Salihu ai komentoi se do të ishte shumë e qëlluar ideja e fragmentarizmit të tokave që mos të ndodhë me pagua shumë aty ku ka pak. Rreth vërejtjes së zj. Rexhepi tha se pakicat duhet të korporatizohen në mënyrë që të kanë suksese në aplikime, përndryshe premtoi se bashkërisht duhet të gjendet alternativa më e përshtatshme për të shfrytëzuar subvencionet edhe pakicat. Pasi pyeti depteten për sugjerimin e sajë zj. **Redzepi** tha se duhet të ndryshoi strategjia e MB dhe ju drejtua ministrit : “ju kemi paralajmëruar për problemet që mund të kemi me pakica dhe subvencione, ndaj kemi sugjerua fondin e veçantë çka ju keni refuzua”. **Fikrim Damka** ndërhyri dhe mori shembull Mamushën ku grante po fitojnë të njëjtit persona por me emra të ndryshëm dhe sugjeroi formimin e listave. Vonesat e pagesave, vazhdoi ministri, ndodhin dhe janë normale ngase duhet me pas masën e kontrollit, nuk mundet me ditë MB dhe me bo pagesën kur mbjellët kultura. Sa i përket qumështarëve potencoi se me këto shoqata MB ka partneritetin më të lartë dhe i mbështetin ata, merren mostrat, paguhen subvencionet por defekti qëndron aty se p.sh. vaji bimor apo shtazor nuk është kompetencë e MB, produktet kanë një standard dhe duhet bërë informimi publik dhe fushatë edukative si p.sh. Serbia që ka vënë masën mbrojtëse prodhimit të qumështit. Rreth afatit të aplikimeve potencoi se janë plotësuar kushtet shumë strikt dhe pokështu janë vlerësuar me transparencë, por sa i përket plotësimi të tyre tha se do të shikohet mundësia e një afati shtesë kur fermerët do të ken kohë me

plotësua mangësit. Në këtë proces edhe komunat janë ato që ndikojnë në bllokim apo zhvillim por MB gjithnjë luan rolin e ndihmuesit për fermerët. Në vazhdimësi MB është duke bërë analizën e efekteve dhe deri tani shihet që kemi më mirë punët me patate, vezë etj dhe duhet me ba përpjekje për ato kultura që ka mungesë, mirëpresë, tha ai, propozimet e juaja lidhur me kuotizime të importit dhe të shikohet mundësia ligjore lidhur me këtë, fundi fundit, çka bënë rajoni edhe na duhet të bëjmë, përfundoi mendimin lidhur me këtë segment të bisedimit. MTI , vazhdoi, ka bërë trajtimin e kërkesave të qumështarëve duke dhënë rekomandime, mirëpo planifikimin dhe konsolidimet duhet të bëjmë bashkërisht si të kultivohet një kulturë, me lista preliminare, masa të përpunimit, ruajtjen e investimeve dhe gjetjen e serrave adekuate, të aplikohet lista e zezë për mashtrues etj. Sa i përket kërkesës së **Murat Hoxhës** ministri tha se komasacioni tani nuk është si dikur që ka qenë, pasi që është masë vullnetare e fermerëve, ndaj MB do të shikoj mundësinë e kombinimit me ujitjen e tokave bujqësore në mënyrë që ata të frymëzohen lidhur me këtë proces. Gjithashtu sipas ndërhyrjes së **Salih Salihut** njoftoi se në agjenci tanimë janë identifikua dy raste në flagrancë rreth spekulimeve , dy mashtrues rreth listave të aplikacioneve, ndaj si përfundim i tij ishte bashkëpunimi dhe frytëzimi i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:15

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka